

REPubLIKA E KOSOVËS
REPubLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETADËME
QENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. 01 Nr. 22581
U. Br.

Nr. i faq. 10 Data: 11/07
Br. str. Datum: 2023
KAMENICËJA



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



RREGULLORE

PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS TË VEPRIMTARIVE AFARISTE – BIZNESEVE NË KOMUNËN E KAMENICËS

KAMENICË, QERSHOR 2023



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja c), nenit 40, paragrafi 40.2, shkronja a) të Ligjit Nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 40, të Ligjit Nr. 2004/L - 18, për Tregtinë e Brendshme, nenit 4, paragrafi 1.2 të Rregullores, Nr. 02/2021, për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, si dhe nenit 46 paragrafi 46.2 shkronja a) të Statutit, Sh. 01. Nr. 005/2008 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30/06/2023 miratoi:

RREGULLOREN

PËR

PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS TË VEPRIMTARIVE AFARISTE – BIZNESEVE NË KOMUNËN E KAMENICËS

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në lëmin e ekonomisë, tregtisë, hotelarisë, zejtarisë dhe shërbimeve të tjera në territorin e Komunës së Kamenicës për ditët e punës, të dielave dhe festave zyrtare.

Neni 2

Fushëveprimi

Të gjitha ndërmarrjet, tregjet publike, dyqanet tregtare, hoteliere, zejtare dhe dyqanet e tjera që kryejnë shërbime në pajtim me dispozitat e Ligjeve në fuqi janë të obliguara që të i përmbahen orarit të punës të përcaktuar më këtë rregullore.

Neni 3

Përkufizimet

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë rregullore, kanë kuptimet si në vijim:

3. 1. **Festë zyrtare** – nënkupton ditën e pushimit për gjithë popullin, e vendosur zyrtarisht nga shteti për një ngjarje me rëndësi të veçantë historike dhe shoqërore.
3. 2. **Inspektori** – nënkupton personin zyrtar me autorizim dhe përgjegjësi të veçanta i cili zbaton mbikëqyrjen inspektuese të afarizmit të subjektit ekonomik.
3. 3. **Lokal afarist** – nënkupton objektin apo hapësirën punuese ku ushtrohet veprimtaria.

3. 4. **Orari i punës** – nënkupton periudhën kohore të fillimit dhe mbarimit të punës.
3. 5. **Orari sezonal** – në kuptim të kësaj rregullore përfshin muajt Korrik, Gusht dhe 15 Dhjetor – 15 Janar.
3. 6. **Periudha verore** – nënkupton periudhën e vitit nga data 1 Prill deri më datë 30 Shtator.
3. 7. **Periudha dimërore** – nënkupton periudhën e vitit nga data 1 Tetor deri më datë 31 Mars.
3. 8. **Person fizik** – nënkupton personin fizik jo afarist që nuk ka të regjistruar aktivitete biznesi dhe personin fizik që ka të regjistruar biznes në bazë të legjislacionit në fuqi dhe zhvillon aktivitet të rregullt afarist.
3. 9. **Person juridik** – nënkupton një shoqëri ose një organizatë tjetër biznesi që ka statusin e një personi juridik sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare dhe çdo legjislacion tjetër në fuqi.
3. 10. **Rregullore** – nënkupton aktin normativ që ka të bëjë me rregullimin e fushave që janë në kompetencë të komunës të përcaktuar me ligjin për vetëqeverisje lokale.
3. 11. **Veprimtaria ekonomike** – nënkupton çdo lloj aktiviteti të rregullt ose të përsëritur i cili përfshinë ofrimin, sigurimin ose prodhimin e mallrave, shërbimeve, pronës ose punëve për një person apo shoqëri tregtare, në këmbim ose në pritje të çfarëdo lloj pagese apo kompensimi, me kusht që punëtori i cili kryen shërbime për punëdhënësin e tij të mos konsiderohet se ushtron veprimtari ekonomike për derisa shërbimet e tilla të kompensohen sipas kontratës së punëtorit me punëdhënësin.
3. 12. **Vikend** – nënkupton ditët e fundjavës (e shtunë dhe e diele).
3. 13. **Zgjatja e orarit të punës** – nënkupton kohën më të gjatë se orari i rregullt i punës.
3. 14. **Afërsi e drejtpërdrejtë** – nënkupton largësinë 100 m nga objekti i banimit.

Neni 4 Orari i Punës

4.1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës i përcaktuar me këtë Rregullore duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin kryhet veprimtaria si dhe duhet saktësuar fillimin dhe mbarimin e orarit të punës.

4.2. Orari i punës përcaktohet në bazë të periudhës verore dhe dimërore:

Periudha verore fillon më: 01 Prill dhe zgjatë deri më 30 Shtator të vitit kalendarik.
Periudha dimërore fillon më: 01 tetor dhe zgjatë deri më 31 Mars të vitit kalendarik.

4.3. Të gjitha veprimtaritë ekonomike që kryejnë shërbime për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të përcaktuar me këtë rregullore duhet të saktësojnë orarin e punës para dite dhe pas dite, si dhe ditët që nuk punohet. Gjithashtu janë të obliguara që lajmërimin për pushim vjetor dhe mjekësor ta vënë në vend të dukshëm pranë lokalit afarist.

Neni 5 Orari i punës për dyqanet zejtare dhe veprimtaritë e ngjashme

5.1. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve:

Në periudhën verore punojnë prej orës 08:00 deri në ora 20:00.

Në periudhën dimërore punojnë prej orës 09:00 deri në ora 18:00.

5.1.1. Ditëve të diela dhe ditëve të festave zyrtare, nuk punojnë, me përjashtim të autolarjeve, të cilat do ta caktojnë një ditë pushimi gjatë javës.

5.2. Rrobaqepësit, këpucëtarët, serviset dhe orëtarët:

Në periudhën verore punojnë prej orës 08:00 deri në ora 20:00.

Në periudhën dimërore punojnë prej orës 09:00 deri në ora 18:00.

5.3. Sallonet e floktarisë dhe trajtimet e tjera të bukurisë:

Në periudhën verore punojnë prej orës 06:00 deri në ora 20:00.

Në periudhën dimërore punojnë prej orës 09:00 deri në ora 19:00.

5.3.1. Ditëve të diela dhe ditëve të festave zyrtare, mund te punojnë, të cilët obligohen ta caktojnë një ditë pushimi gjatë javës.

5.4. Salduesit, teneqepunuesit, farkëtarët dhe dyqanet e tjera zejtare:

Në periudhën verore punojnë prej orës 08:00 deri në ora 19:00.

Në periudhën dimërore punojnë prej orës 08:00 deri në ora 18:00.

5.4.1. Ditëve të diela dhe ditëve të festave zyrtare, nuk punojnë.

Neni 6

Orari i punës për furrat e bukës

Furrat e bukës mund të punojnë çdo ditë 24 orë.

Neni 7

Orari i punës për Qendrat tregtare, Shtëpitë e mallrave, Vetëshërbimet, Shitoret ushqimore, mishtoret, kioskat dhe dyqanet e tjera tregtare jo ushqimore

7.1. Qendrat tregtare, shtëpitë e mallrave, vetëshërbimet, shitoret ushqimore, mishtoret dhe kioskat:

Në periudhën verore punojnë prej orës 07:00 deri në ora 23:00.

Në periudhën dimërore punojnë prej orës 08:00 deri në ora 22:00.

7.1.1. Ditëve të diela dhe ditëve të festave zyrtare veprimtaritë nga paragrafi 7.1 nuk mund të

punojnë me përjashtim të shitoreve ushqimore në fshatra të cilat mund të punojnë deri në ora 12:00.

7.2. Dyqanet e tjera tregtare jo ushqimore:

Në periudhën verore punojnë prej orës 07:00 deri në ora 20:00.

Në periudhën dimërore punojnë prej orës 08:00 deri në ora 19:00.

7.3. Auto sallonet, auto pjesët e automjeteve të përdorura:

Në periudhën verore punojnë prej orës 08:00 deri në ora 20:00.

Në periudhën dimërore punojnë prej orës 08:00 deri në ora 18:00.

7.4. Ditëve të diela dhe ditëve të festave zyrtare, nuk mund të punojnë.

Neni 8

Orari i punës për tregjet publike

8.1. Tregjet e gjelbër ta:

Në periudhën verore mund të punojnë çdo ditë pune prej orës 06:00 deri në ora 18:00.

Në periudhën dimërore mund të punojnë çdo ditë pune prej orës 07:00 deri në ora 17:00.

8.1. 1. Ditëve të diela mund të punojnë deri në ora 13:00.

8.2. Tregjet e kafshëve mund të punojnë në qytet vetëm ditën e premte prej orës 06:00 deri në ora 18:00, ndërsa në fshatra mund të punojnë ditën e mërkurë prej orës 06:00 deri në ora 18:00 dhe ditën e diele prej orës 06:00 deri në ora 13:00.

8.2.1. Nuk është e lejueshme shitja e kafshëve në treg apo në vende të tjera publike ditëve të tjera pa pëlqimin e organit kompetent komunal.

Neni 9

Orari i punës në Gastronomi

9.1. Orari i punës për Restorantet, Veprimtaritë shërbyese të pijeve, Qebaporet, Gjellëtoret, Fast-Food, Veprimtaritë lëvizëse të ushqimit, internet kafet dhe veprimtaritë e ngjashme:

Në periudhën verore fillon prej orës 07:00 dhe mbaron në ora 24:00.

Në periudhën dimërore fillon prej orës 07:00 dhe mbaron në ora 23:00.

9.2. Diskotekat mund të punojnë ditëve të Premte dhe të Shtune si dhe gjatë festave në bazë të ligjit për festa zyrtare deri në ora 03:00, kurse për ditë të tjera obligohen që të pajisen me pëlqim nga organi kompetent komunal.

9.3. Hotelet dhe akomodimi i ngjashëm mund të punojnë 24 orë për të dy periudhat kohore.

9.4. Objektet të cilat gjenden në afërsi deri në 100 m në zonen e objekteve të banimit, nuk lejohet, të organizohet program live apo me audio-video mjete me riprodhim të programit, ndërsa mbi 100 m, largësi programi mund të mbahet deri në ora 24:00.

Neni 10

Orari i punës për aktivitetet sportive dhe rekreative, lojërat zbavitëse dhe kompjuterike

10.1. Orari për të dy sezonet në stadione, palestra sportive dhe objekte të tjera rekreative, fillon në ora 08:00 dhe mbaron në ora 00:00.

10.2. Lojërat zbavitëse dhe kompjuterike:

Në periudhën verore punojnë prej orës 07:00 deri në ora 00:00.

Në periudhën dimërore punojnë prej orës 08:00 deri në ora 23:00.

10.3. Orari për të dy sezonet në qendrat e trajnimit për aftësim praktik dhe teorik me armë, fillon në ora 08:00 dhe mbaron në ora 22:00.

10.4. Ditëve të diela dhe ditëve të festave zyrtare, nuk mund të punojnë, përjashtimisht veprimtaritë nga paragrafi 10.1 i këtij neni.

10.5. Parqet e lojërave mund të punojnë në periudhën verore deri në ora 24:00, ndërsa në periudhën dimërore deri në ora 22:00.

Neni 11

Orari i punës në pikat për shitjen e karburanteve

Pikat për shitjen e karburanteve dhe tregtia me pakicë e artikujve ushqimorë, pijeve dhe duhanit të cilat gjenden në një objekt (pikë karburanti) mund të punojnë 24 orë në ditë.

Neni 12

Orari i punës për barnatoret, ordinancat dhe klinikat private

12.1. Barnatoret punojnë për të dy sezonet prej orës 07:00 deri në ora 23:00, me përjashtim të ditëve të diela.

12.2. Barnatoret gjatë ditëve të diela dhe festave zyrtare do të punojnë në harmoni me planin për kujdestari të hartuar në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, vetëm një barnatore kujdestare me rotacion.

12.3. Barnatoret kujdestare mund punojnë gjatë ditëve të punës prej orës 23:00 deri në ora 07:00, sipas paragrafit 12.2.

12.3.1. Barnatoret kujdestare gjatë ditëve të diela dhe festave zyrtare duhet të punojnë prej orës 07:00 deri në ora 23:00, sipas paragrafit 12.2.

12.3.2. Barnatoret kujdestare gjatë ditëve të diela dhe festave zyrtare pas orës 23:00, mund të punojnë sipas paragrafit 12.2.

12.4. Ordinancat dhe Klinikat private punojnë për të dy sezonet prej orës 07:00 deri në ora 20:00.

Neni 13

Orari i punës për barnatoret bujqësore, dyqanet me produkte bujqësore dhe ordinancat veterinare

13.1. Barnatoret bujqësore, ordinancat veterinare dhe dyqanet me produkte bujqësore:

Në periudhën verore punojnë prej orës 08:00 deri në ora 19:00;

Në periudhën dimërore punojnë prej orës 08.00 deri në ora 18:00;

13.2. Ditëve të diela dhe ditëve të festave zyrtare nuk mund të punojnë.

Neni 14

Orari i punës në ndërtimtari dhe infrastrukturë

14.1. Ndërmarrjet ndërtimore dhe infrastruktura:

Në periudhën verore punojnë prej orës 07:00 deri në ora 17:00;

Në periudhën dimërore punojnë prej orës 08:00 deri në ora 17:00;

14.2. Ndërmarrjet ndërtimore dhe infrastrukturë në raste të jashtëzakonshme për shkak të natyrës së punëve me leje të veçantë të cilën e lëshon Drejtoria përkatëse mund të punojnë me orar të zgjatur deri në ora 24:00.

14.3. Ditëve të diela dhe ditëve të festave zyrtare nuk mund të punojnë.

Neni 15

Orari i punës për seperacione dhe gurore

15.1. Seperacionet dhe guroret:

Në periudhën verore punojnë prej orës 07:00 deri në ora 17:00;

Në periudhën dimërore punojnë prej orës 08.00 deri në ora 17:00;
15.2. Ditëve të diela dhe ditëve të festave zyrtare nuk mund të punojnë.

Neni 16

Orari i punës i veprimtarive financiare dhe të sigurimit

16.1. Veprimtaritë financiare dhe të sigurimit në dy periudhat kohore punojnë prej orës 08:00 deri në ora 17:00;
16.2. Ditëve të diela dhe ditëve të festave zyrtare nuk mund të punojnë.

Neni 17

Orari i punës së veprimtarive të patundshmërive, veprimtarive profesionale, shkencore dhe teknike

17.1. Veprimtaritë e patundshmërive, veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike:

Në periudhën verore punojnë prej orës 08:00 deri në ora 18:00;

Në periudhën dimërore punojnë prej orës 08:00 deri në ora 17:00;

17.2. Ditëve të diela dhe ditëve të festave zyrtare nuk mund të punojnë.

Neni 18

Orari i punës i veprimtarive private edukativo – arsimore, edukimit joformal, kurseve profesionale dhe auto shkollave

18.1. Veprimtaritë arsimore dhe edukimi jo formal:

Në periudhën verore punojnë prej orës 07:00 deri në ora - 21:00;

Në periudhën dimërore punojnë prej orës 07:00 deri në ora 20:00;

18.2. Ditëve të diela dhe ditëve të festave zyrtare nuk mund të punojnë.

Neni 19

Orari i punës për biznese përpunuese dhe prodhuese

19.1. Bizneset përpunuese dhe prodhuese:

Në periudhën verore punojnë prej orës 08:00 deri në ora 20:00;

Në periudhën dimërore punojnë prej orës 08:00 deri në ora 19:00;

19.2. Bizneset përpunuese dhe prodhuese mund të punojnë 24 orë pa ndërprerë, nëse në ato biznese nuk mund të ndalet procesi i përpunimit dhe prodhimit.

19.3. Ditëve të diela dhe ditëve të festave zyrtare nuk mund të punojnë.

Neni 20

Veprimtaritë e tjera ekonomike

Për veprimtaritë e tjera ekonomike të cilat nuk janë përshkruara në këtë rregullore, orari i punës është i njëjtë me ato veprimtari në të cilat bëjnë pjesë varësisht se në cilin sektor bëjnë pjesë duke ju referuar Klasifikimit të veprimtarive ekonomike.

Neni 21

Dispozitat ndëshkuese

21.1. Të gjitha subjektet afariste të cilat veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregullore do të dënohen me dënim kundërvajtës në shumën prej:

- 21.1.1. për personin fizik dhe personin përgjegjës të personit juridik është njëqind (100) euro;
- 21.1.2. për personin fizik që ushtron biznes individual është dyqind (200) euro;
- 21.1.3. për personin juridik është pesëqind (500) euro.

21.2. Në rastin e pagimit të gjobës, në afatin e përcaktuar me urdhrin kundërvajtës, i dënuari lirohet nga pagimi 50% nga shuma e gjobës së shqiptuar.

21.3. Nëse kryerësi pjesërisht ose në tërësi nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përmbarim. Urdhri kundërvajtës përmes të cilit shqiptohet gjoba do të cilësohet dokument përmbarues në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurën përmbarimore.

21.4. Gjobat e përcaktuara në këtë rregullore paguhen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve por jo më vonë së tridhjetë (30) ditë nga data e shqiptimit të tyre.

Neni 22

Zgjatja orarit të punës

22.1. Restorantet dhe objektet hoteliere, mund të punojnë më gjatë së orari i punës i përcaktuar me këtë Rregullore pa pagesë në rastet e organizimit të dasmave dhe ahengjeve familjare.

22.2. Për punën më të gjatë së sa orari i paraparë me këtë Rregullore, duhet të merret pëlqim nga organi kompetent komunal.

22.3. Për çdo vazhdim të orarit të punës duhet të paguhet taksa në llogari të komunës:

22.3.1. Restorantet, kafiteritë, akomodimet tjera hoteliere dhe diskotekat..... 10.00 €/orë.

22.4. Të gjitha subjektet afariste të cekura në nenin 5 dhe 7 të kësaj Rregullore mund të punojnë edhe ditëve të diela dhe festave zyrtare pa pagesë sipas orarit sezonal për muajt Korrik, Gusht dhe nga data 15 Dhjetor deri më datë 15 Janar.

Neni 23

Zbatimi

Të gjitha veprimtaritë ekonomike janë të obliguara që gjatë ushtrimit të veprimtarive të tyre ekonomike të mos bien ndesh me këtë Rregullore, Ligjin nr. 03/L-142 për Rendin dhe Qetësinë publike, Ligjin nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga zhurma si dhe aktet e tjera nënligjore të kësaj lëmie.

Neni 24

Dispozitat përfundimtare

Për zbatimin e kësaj Rregullore do të kujdeset inspektorati komunal, gjegjësisht inspektorët kompetent.

Neni 25

Shfuqizimi

Më hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, Shfuqizohet Rregullorja mbi Përcaktimin e Orarit të Punës në Lëmin e Ekonomisë, Tregtisë, Zejtarisë dhe Shërbimeve tjera në territorin e Komunës së Kamenicës nr. 13104, e dt. 05.05.2016, të gjitha vendimet komunale dhe aktet e tjera në lidhje me përcaktimin e orarit të punës.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga dita e vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Web faqen e Komunës së Kamenicës.


Eiridon KASTRATI
Kryesues i Kuvendit të Kamenicës